



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagri 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagri 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 14.03.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Obligohet zyrtari i lartë z. Shukri Gashi që të zbatoj kufizimet:
- a) lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të licencuar të pronave të paluajtshme, konform nenit 12 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik;
- b) për sa i përket shpërblimit me pagesë për shkak të funksioneve të dyfishta publike, konform nenit 13, paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik;
- II. Është shhangj gjendja e papajtueshmërisë me ushtrim të funksionit publik për shkak të ndryshimeve të duhura nga zyrtari i lartë për sa i përket funksioneve në biznese private, konform nenit 13, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik;
- III. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjtë publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

Rasti APK-DPKI-06-208/24, i hapur sipas kërkesës së zyrtarit të lartë z. Shukri Gashi, anëtar i bordit të përkohshëm në NSH INEX Sharr Planina - Brezovicë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas një *kërkese për interpretim* nga vet zyrtari i lartë lidhur me funksionet që ushtron kryesisht në institucionet publike.

Më gjerësisht në kërkesën e tij zyrtari i lartë ka deklaruar se (*citojmë nga kërkesa*):

"Jam vlerësues i licencuar për prona të paluajtshme me numër VPP-259 dhe se mirrem me vlerësimë kryesisht për klient privat, kryesisht kur dëshirojnë të shitblejn ndonjë pronë dhe rrallë herë ndoshta edhe për deklarime të pasurisë në shtetet tjera (atje ku jetojnë klientë), edhe më rrallë me kërkesë të klientëve për ndonjë aplikim eventual për ndonjë kredi (në

bankat ku lejohet vlerësuesi i jashtëm, sepse shumica e bankave ose i kanë vlerësuesit e tyre ose kanë kontrata me kompani të ndryshme vlerësimi.

Jam anëtar i bordit të përkohshëm me mandat një vjeçar nga 29 Qershor 2023 deri me 28 Qershor 2024 në NSH INEX Sharr Planina - Brezovicë, e që është nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit – AKP dhe se

Nga data 05 Shkurt 2024 do filloj punën në TREPÇA SHA - Mitrovicë si Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit.

A është konflikt interes i që unë jam edhe vlerësues për prona të paluajtshme dhe në të njëjtën kohë jam edhe anëtar i bordit të përkohshëm të lartetur?

A është konflikt interes i që të jem edhe anëtar i bordit të përkohshëm nën menaxhimin e AKP-së e në të njëjtën kohë edhe Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit në Trepça SHA?"

I. a) Fillimisht, sa i përket ushtrimit të veprimtarisë së vlerësuesit të licencuar për prona të paluajtshme nga ana e z. Shukri Gashi, duke qenë se i njëjti njëkohësisht ushtron funksione të zyrtarit të lartë publik, neni 12 i LPKI-së [Kufizimi i zyrtarit të lartë në ushtrimin e veprimtarive të tjera krahas ushtrimit të funksionit publik] ka përcaktuar se:

1. *"Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë veprimitari profesionale të avokatisë, noterisë, përmbaruesit privat, administratorit të falimentimit, ekspertit të licencuar, konsulentit ose agjentit të personave juridikë si dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër".*
2. *"Në kuptim të këtij neni, veprimitari profesionale nënkuptojnë veprimitaritë për të cilat kërkohet licencim sipas ligjit në fuqi".*

Pra, në bazë të legjisacionit relevant në fuqi [Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe/ose Udhëzim Administrativ (MFPT) Nr. 01/2021 për Këshillin Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme], vlerësuesit e pronave licencohen nga Këshilli Mbikëqyrës të cilin e themelon Ministria e Financave (neni 17, paragrafi 3 i Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme), e që veprimitaria e vlerësuesit të pronave të paluajtshme është veprimitari për të cilën kërkohet licencim sipas ligjit në fuqi.

Prandaj, në rastin konkret, ushtrimi i veprimitarisë së vlerësuesit të licencuar për prona të paluajtshme nga ana e z. Shukri Gashi, duke qenë njëkohësisht zyrtar i lartë publik, është i ndaluar me dispozitat e sipërcituara të LPKI-së.

I. b) Ndërsa, sa i përket ushtrimit të funksioneve tjera nga zyrtari i lartë në fjalë të përmendura në kërkesën e tij, sqarojmë se nga cilësia e anëtarit të bordit të përkohshëm në NSH INEX Sharr Planina - Brezovicë, e gjithashtu si Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit në TREPÇA SHA, i njëjti ka status të zyrtarit të lartë publik, në kuptim të nenit 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i LPKI-së, me të cilin përcaktohet se: "Zyrtar i lartë - nënkupton zyrtarët e lartë publike të përcaktuar sipas Ligjit përkates për deklarimin, kontrollin dhe prejardhjen e pasurisë", lidhur me nenin 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.15, përkatesisht 1.36 të Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, me të cilin është përcaktuar se: "Për qëllimet e këtij ligji, lista e zyrtarëve të lartë është si më poshtë: [...] Kryesuesit dhe anëtarët e bordeve dhe drejtorët e përgjithshëm të ndërmarrjeve publike; [...], përkatesisht, [...] Udhëheqësit e të gjitha departamenteve, drejtorive, njësive të auditimit dhe

njësive të barasvlershme, udhëheqësit e financave, buxhetit në të gjitha institucionet publike në nivelin lokal dhe qendror dhe në ndërmarrjet publike në nivelin lokal dhe qendror.

Kësisoj, me dispozitat e LPKI-së, zyrtarit të lartë *parimisht* nuk i ndalohet që të ushtrojë njëkohësisht këto dy funksione, në rastin konkret, Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit në Trepça SHA, dhe anëtar i bordit të përkohshëm në NSH INEX Sharr Planina - Brezovicë, por megjithatë, dispozitat e LPKI-së kanë paraparë disa kufizime në aspekt të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, konkretisht dispozita e nenit 13 [*Papajtueshmëria me ushtrimin e funksionit publik*], paragrafi 2 i LPKI-së ka përcaktuar se:

"Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institacioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj. Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërbllimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të".

Dispozita në fjalë ka përcaktuar dy kufizime për zyrtarët e lartë, edhe atë kufizimi i parë përcakton se *"zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të institacioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj"*, ndërsa kufizimi i dytë përcakton se *"zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organit drejtues të institacioneve të tjera publike, nuk ka të drejtë shpërbllimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të"*.

Prandaj, në rastin konkret, zyrtari i lartë z. Shkuri Gashi (në cilësinë Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit në Trepça SHA), ka të drejtë të jetë anëtar i vetëm një (*por jo më shumë se një*) organi drejtues të institacioneve të tjera publike (siç është anëtar i bordit të përkohshëm në NSH INEX Sharr Planina - Brezovicë), *por, nuk ka të drejtë shpërbllimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të*.

II) Gjatë trajtimit të kërkesës së zyrtarit të lartë, është gjetur se i njëjti ishte përfaqësues i Autorizuar në bizneset private: *"A2Z Financials SH.P.K." dhe "NE3 MITROVICA SH.P.K."*.

Më pas, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka realizuar disa komunikime (*përmes telefonit*) me zyrtarin e lartë z. Shukri Gashi, me ç'rast ai është njofshuar që si zyrtar i lartë (anëtar i bordit të përkohshëm në NSH INEX Sharr Planina - Brezovicë), nuk mund që njëkohësisht të jetë përfaqësues i autorizuar në biznese private, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1, të LPKI-së, ku thuhet se:

"Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë private, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektit e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektit politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit".

Pas diskutimit dhe sqarimit të të gjitha faktave, zyrtari i lartë është pajtuar me konstatimet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, duke deklaruar se do të ndërmarr veprime konkrete në mënyrë që të shmangë papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, pas verifikimeve të duhura, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka konstatuar se zyrtari i lartë në fjalë ka bërë ndryshimet e kërkua nga Agjencia, të cilat dëshmohen përmes uebfaqes zyrtare të Agjencisë për Regjistrimin e Biznese të Kosovës (ARBK), e ku e njëjtë nuk figuron më të jetë përsaqësues i autorizuar në ato biznese.

Me veprimet e ndërmarrja nga zyrtari i lartë, janë krijuar rrethana të atilla me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik për sa i përket funksioneve në bizneset e sipërpermendura.

III. Agjencia vendosi si në pikën III, të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: "*Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimitarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.*", si dhe paragafin 15 të këtij nenit, me të cilin është përcaktuar se: "*Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.*"

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:


YLLI BULESHKAI
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)